



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 05 Janar 2017

NJOFTIM

Buxheti i rritur i Spitalit të fëmijëve Kozle dedikohet për metodat e reja dhe për një kujdes shëndetësor me kualitet më të lartë

Drejtorët e Fondit për sigurim shëndetësor të Maqedonisë, Orhan Ramadani dhe d-r Sasho Stefanoski, sot e vizituan Spitalin e fëmijëve 'Kozle' dhe realizuan takim pune me drejtorin mjekësor d-r Oliver Zafirovski, drejtorin ekonomik Rijad Alimi dhe me ekipin menaxhues të spitalit.



Temë diskutimi në takimin e sotshëm ishte Programi i punës për vitin 2017 që e ofron Spitali i fëmijëve 'Kozle' dhe mjetet e rritura financiare që e karakterizojnë buxhetin për këtë vit. Respektivisht, Spitali i fëmijëve 'Kozle' përvetëson buxhet prej 125,9 milion denarëve ose rritje prej 10 milion denarëve nga viti 2016. Rritja e mjeteve dedikohet për furnizimin e paisjeve ortopedike bashkëkohore ashtu që fëmijët me fibrozë cistike t'a pranojnë terapinë e nevojshme, si dhe për skringjet neonatale për zbulimin e



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



sëmundjeve të fshehta tek foshnjët. Sa për ilustrim, buxheti i Spitalit në vitin 2016 ka qenë 115,900 milion denarë ndërsa në vitin 2015 ka qenë 108,000 milion denarë.

Vlen të theksohet fakti se Spitali i fëmijëve 'Kozle' funksionon në kushte bashkëkohore falë mjeteve që u siguruan për investim kapital nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në vlerë prej 500 milion denarëve dhe aparaturave të reja që do t'ju shërbejnë të siguruarve tanë.

Në përfundim të takimit u shpreh kënaqësia ndaj kujdesit që Fondi e tregon për shëndetin publik i cili, vizavi Planeve të mira të menaxhimit të institucioneve shëndetësore publike dhe përkushtimit të vazhdueshëm për t'a përmirësuar kualitetin e shërbimeve shëndetësore, angazhohemi për interesin e përbashkët respektivisht, do t'ia arrimë qëllimit të vetëm për të kënaqur nevojat e pacientëve dhe të punësuarve shëndetësor.